

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
“RROBAQEPSI”

Kodi: PK-D-1-18

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2018

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“ROBAQEPSI”

(PK-D-1-18)

I. Profili Profesional i rrobaqepsit

a) *Karakteristikat e rrobaqepsit*

Rrobaqepsi është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar në ndërmarrje të rrobaqepsisë, rrobaqepsi dhe atelie, apo si i vetëpunësuar për prodhimin ose riparimin e veshieve të ndryshme.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, rrobaqepsi duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale në fushën e rrobaqepsisë.

Suksesi i rrobaqepsit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, korrektësia, disiplina, etika e komunikimit etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e rrobaqepsit*

Profesioni i rrobaqepsit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për prodhimin, riparimin dhe përshtatjen e veshjeve të ndryshme. Ai mund të punësohet në fabrika dhe reparte të prodhimit të veshjeve, rrobaqepsi dhe atelie, ose mund të vetëpunësohet si rrobaqepës.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e rrobaqepsit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një rrobaqepës mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si drejtues reparti, teknik i rrobaqepsisë apo si modelist dhe stilist. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinerit të konfeksionit.

Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën rrobaqepsisë dhe shërbimeve të saj, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Rrobaqepës (fustane, kapele, gëzof etj.)” me kod 7531, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në prodhimin e produkteve të mëposhtme, të tilla si këmisha, kostume, qepje perdeshe, veshje kolltukësh, divanesh etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për rrobaqepsi

Në përfundin të Kursit për rrobaqepsi, kursantët do të jenë të aftë të:

- konsultohen me klientët për porositë e marra;
- parapërgatitin vendin e punës për fillimin e punës;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet dhe materialet e punës;
- bëjnë modelime të thjeshta sipas kërkesave të klientit;
- bëjnë llogaritjen e kostos së porosisë;
- bëjnë marrjen e masave të klientit për veshjen e kërkuar;
- përdorin dokumentacion për rrobaqepsinë;

- bëjnë skicime të thjeshta të modelit;
- përpunojnë kallëpin e veshjes së kërkuar sipas masave dhe modelit të përzgjedhur nga klienti;
- bëjnë prerjen e copës në përputhje me kallëpin apo përmasat e klientit;
- bëjnë përgatitjen e mjeteve dhe makinave të punës;
- bëjnë qepjen paraprake sipas llojit të veshjes;
- kryejnë punimet e duhura me dorë në përputhje me kërkesat e veshjes;
- bëjnë provën e veshjes në trup ose në manikin;
- kryejnë modifikimet e veshjes pas nxjerrjes nga prova;
- bëjnë kontrollin përfundimtar të veshjes;
- vendosin aksesore dhe dekoracione të ndryshme;
- bëjnë hekurosjen dhe paketimin e veshjes së porositur;
- bëjnë riparime të ndryshme (zgjerime, ngushtime apo përshtatje) sipas kërkesës së klientit;
- kryejnë mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës;
- zbatojnë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojnë standardet e profesionit të rrobaqepsisë;
- komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për rrobaqepsi.

Pjesmarrësit në Kursin për rrobaqepsi duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Rrobaqepsi

360 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për rrobaqepsi

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë	MK-10-112-18	10 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan profesionin e rrobaqepsisë 2. Kursanti përshkruan veshjet, materialet dhe mjetet e punës së rrobaqepsisë 3. Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në rrobaqepsi
2	Punime të thjeshta në rrobaqepsi	MK-10-113-18	40 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen matje dhe shënime të rrobaqepsisë 2. Kursanti kryen prerje të copave dhe materialeve ndihmëse 3. Kursanti kryen qepje me dorë 4. Kursanti kryen hekurosje dhe frazelinim

3	Punime elementare në rrobaqepsi	MK-10-114-18	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti qep pensa 2. Kursanti formon molesa 3. Kursanti përgatit rrudha 4. Kursanti qep pala 5. Kursanti qep fileto
4	Qepja me makina qepëse familjare dhe industriale	MK-10-115-18	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan llojet, ndërtimin, funksionimin dhe përdorimet e makinave qepëse. 2. Kursanti kryen qepje me makinat qepëse familjare 3. Kursanti kryen qepje në makinat qepëse syzator 4. Kursanti kryen qepje në makinat qepëse lineare 5. Kursanti kryen qepje në makinat qepëse të birkopsave 6. Kursanti rregullon defektet e thjeshta në procesin e qepjes me makina
5	Konfeksionimi i fundeve	MK-10-116-18	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin e fundit të thjeshtë 2. Kursanti pret fundin e thjeshtë 3. Kursanti qep fundin e thjeshtë 4. Kursanti qep funde me supanjë dhe pala 5. Kursanti qep funde me modele xhepush të ndryshëm
6	Konfeksionimi i jakave, mëngëve dhe xhepave	MK-10-117-18	30 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti konfeksionon jaka 2. Kursanti konfeksionon mëngë 3. Kursanti konfeksionon xhepa
7	Konfeksionimi i pantallonave	MK-10-118-18	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin e pantallonave 2. Kursanti pret pantallonat 3. Kursanti kryen provën e pantallonave 4. Kursanti qep pantallonat 5. Kursanti kryen proceset përfundimtare të pantallonave
8	Konfeksionimi i këmishave	MK-10-119-18	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit kallëpin e këmishës 2. Kursanti pret këmishën 3. Kursanti kryen provën e këmishës 4. Kursanti qep këmishën 5. Kursanti kryen proceset përfundimtare të këmishës

9	Konfeksionimi i fustaneve	MK-10-120-18	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përgatit kallëpin e fustanit 2. Kursanti pret fustanin 3. Kursanti kryen provat e fustanit 4. Kursanti qep fustanin 5. Kursanti kryen proceset përfundimtare të fustanit
---	---------------------------	--------------	--	--

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për rrobaqepsi:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E RROBAQEPSISË	MK-10-112-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të rrobaqepsit, me produktet, materialet dhe proceset e rrobaqepsisë dhe me rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit në rrobaqepsi	
Kohëzgjatja e modulit	10 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përshkruan profesionin e rrobaqepsisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë rëndësinë e sektorit të rrobaqepsisë në ekonominë e vendit.- të përshkruajë rolin dhe ndikimin e veshjeve të individit dhe shoqëria.- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së rrobaqepsit.- të përshkruajë mjediset dhe kushtet e punës së rrobaqepsit.- të përshkruajë proceset bazë të rrobaqepsisë.- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor rrobaqepsi.- të përshkruajë organizimin e punës në rrobaqepsi.- të përshkruajë kërkesat profesionale për rrobaqepsin.- të tregojë mundësitë e punësimit të rrobaqepsit.- të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të rrobaqepsit.- të tregojë procedurën për liçensimin e veprimtarisë së rrobaqepsit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Pyetje përgjigje me shkrim.	
	<p>RM 2 Kursanti përshkruan veshjet, materialet dhe mjetet e punës së rrobaqepsit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">- të dallojë veshjet sipas moshës, seksit, lëndës së parë dhe stinës së përdorimit të tyre	

- të përshkruajë shkallën e komoditetit që sigurohet me anë të zgjedhjes së materialit
- të tregojë karakteristikat e higjenës së veshjeve si mbajtja e nxehtësisë së trupit, thithja e djersës si dhe përçueshmëria e ajrit
- të përshkruajë pamjen estetike të materialit të zgjedhur sipas funksionit, cilësisë dhe kostos.
- të dallojë materialet bazë që përdoren për veshje si leshti, pambuku, liri, kërpi, mëndafshi, sintetike etj.
- të përshkruajë materialet ndihmëse dhe aksesorët e rrobaqepsisë si astar, frazelinë, penj, kopsa, susta, zinxhir, garnitura të ndryshme, vata, penj, llastikë etj.
- të përshkruajë funksionin e mjeteve për matje dhe shënime si metër shirit, vizore njëmetroshe, kurbalinjë, sapun shkruar, shkumës etj.
- të përshkruajë funksionin e mjeteve për prerje si tavolinë, vizore njëmetroshe dhe llojet e ndryshme të gërshërve dhe pajisjeve prerëse.
- të përshkruajë funksionin e mjeteve për qepje si gishtëza, gjilpërat e dorës, penj të ndryshëm, gjilpëra me kokë etj.
- të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e përgjithshëm të makinave qepëse të llojeve të ndryshme
- të përshkruajë pajisjet e ndryshme që përdoren në rrobaqepsi si hekurat dhe tavolinat për hekurosje, presat, tavolinat e punës, manikinët, garderobat dhe varëset e rrobave, raftet e materialeve etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit, sigurisë, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit në rrobaqepsi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rregullat dhe rëndësinë e komunikimit me etikë profesionale me klientin dhe me të tjerë.
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e sigurimit teknik që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga rryma elektrike, dëmtimet nga makinat dhe pajisjet prerëse, dëmtimet nga nxehtësia dhe zjarri etj.
- të përshkruajë masat dhe mjetet për mbrojtjen nga zjarri.
- të përshkruajë masat dhe mjetet për dhënie të ndihmës së parë për të dëmtuarit.
- të përshkruajë rregullat e higjenës personale dhe rëndësinë e mbajtjes pastër dhe të rregullt të mjediseve të punës
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punës së rrobaqepsit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të rrobaqepsit, të dallojnë veshjet, materialet dhe mjetet e punës, si dhe të përshkruajnë rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në rrobaqepsi. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Komplete veshjesh të ndryshme.
 - Kompletet e materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME TË THJESHTA NË RROBAQEPSI	MK-10-113-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e punimeve të thjeshta të rrobaqepsisë, si dhe i aftëson ata të kryejnë matje, shënime, prerje, qepje me dorë, hekurosje dhe frazëlinim të copave dhe të materialeve ndihmëse.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen matje dhe shënime të rrobaqepsisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të argumentojë rëndësinë që kanë matjet e sakta në rrobaqepsi;- të dallojë mjetet matëse dhe shënuese dhe tregojë përdorimet e tyre në rrobaqepsi;- të përgatitë tavolinën e punës për matje dhe shënime të materialeve tekstile;- të tregojë mënyrën e marrjes së masave të klientit;- të përzgjedhë mjetet matëse dhe shënuese;- të marri masat trupore të klientit me metër shirit;- të dallojë proporcionet dhe difektet trupore të klientit;- të shkruajë masat e porosisë së klientit, duke përdorur tabelën e masave;- të kryejë matjet e materialit tekstil me metër shirit;- të kryejë matjet e materialit tekstil me vizore shirit;- të përdorë sapunin shkruar dhe shkumësin për shënime dhe vizatime në materialin tekstil;- të përdorë kurbalinjën për shënimin e pjesëve të lakuara në materialin tekstil;- të përdorë rrotën kopjuese për të kopjuar bazat prej letre;- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.- të komunikojë me etikë profesionale- të zbatojë rregullat e higjinës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit; Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti kryen prerje të copave dhe materialeve ndihmëse Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

- të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e prerjes së copave dhe materialeve ndihmëse në rrobaqepsi;
- të përzgjedhë mjetet prerëse dhe të tregojë përdorimet e tyre në rrobaqepsi;
- të përgatitë tavolinën e punës për prerjen e copave dhe materialeve ndihmëse;
- të përshkruajë procedurën e prerjes me mjete të ndryshme prerëse në rrobaqepsi;
- të përzgjedhë mjetet matëse dhe shënuese për prerjen;
- të kryejë matjet dhe shënimet e copave dhe materialeve ndihmëse, për prerjen e tyre;
- të kryejë prerjen e copave dhe materialeve ndihmëse me gërshtë dore, të madhësive të ndryshme;
- të kryejë prerjen e copave dhe materialeve ndihmëse me gërshtë të dhëmbëzuara;
- të kryejë prerjen e copave dhe materialeve ndihmëse me gërshtë elektrike dore.
- të sistemojë dhe mirëmbajë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e higjinës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë prerjes;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen qepje me dorë

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e qepjes me dorë në rrobaqepsi;
- të përzgjedhë mjetet për qepjen me dorë dhe të tregojë përdorimet e tyre në rrobaqepsi;
- të përshkruajë llojet e gjilpërave dhe penjëve për qepjen me dorë;
- të përgatitë vendin e punës për qepje me dorë të copave dhe materialeve ndihmëse;
- të përshkruajë procedurën e qepjes me dorë, me tegela të llojeve të ndryshme;
- të përzgjedhë mjetet matëse dhe shënuese për qepjen me dorë;
- të kryejë matjet dhe shënimet e copave dhe materialeve ndihmëse, për qepjen e tyre;
- të qepë me dorë kopsa;
- të qepë me dorë palat e fundit të veshjes;
- të bëjë ildisje të ndryshme (pasi, nevert etj.);
- të bëjë iliqe dhe vrima me punëdore;
- të bëjë punëdore të brendëshme të veshjes;
- të sistemojë dhe mirëmbajë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e higjinës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë qepjes;

së mjedisit gjatë qepjes;

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë;
- Vlerësimi me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen hekurosje dhe frazelinin

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet hekurosjes dhe frazelinimit në rrobaqepsi;
- të përshkruajë procedurën e hekurosjes dhe procedurën e frazelinimit;
- të interpretojë etiketat e materialeve dhe veshjeve të ndryshme, për të përcaktuar parametrat e hekurosjes dhe të frazelinimit;
- të për zgjedhë mjetet për hekurosjen dhe materialet për frazelinin dhe të tregojë përdorimet e tyre në rrobaqepsi;
- të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e llojeve të ndryshme të hekurave për hekurosje dhe frazelinin (hekur i thjeshtë, hekur me avull, hekur me gradim temperature, presë etj.).
- të përshkruajë ndërtimin dhe përdorimin e tavolinave të ndryshme për hekurosje dhe frazelinin;
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës punës për hekurosje dhe frazelinin;
- të përcaktojë parametrat e hekurosjes dhe frazelinimit;
- të kryejë hekurosje të pjesëve të ndryshme të veshjeve, me hekur të thjeshtë për hekurosje;
- të kryejë hekurosje të pjesëve të ndryshme të veshjeve, me hekur me avull dhe me gradim temperature;
- të kryejë hekurosje të pjesëve të ndryshme të veshjeve, me presë;
- të përdorë jastëkë të formave të ndryshme, për hekurosjen e pjesëve të veçanta të veshjeve;
- të realizojë ngjitje të frazelinave të ndryshme, me hekur;
- të realizojë ngjitje të frazelinave të ndryshme, me presë;
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për hekurosje dhe frazelinin;
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit;

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë;
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.

-
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për të kryer proceset e matjes, shënimit, prerjes, qepjes me dorë, hekurosjes dhe frazelimit, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për matje, shënime, prerje, qepje me dorë, hekurosje dhe frazelinim.
 - Veshje, copa dhe frazelina të ndryshme.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Punime elementare në rrobaqepsi”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME ELEMENTARE NË RROBAQEPSI	MK-10-114-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantë me veçoritë e punimeve elementare në rrobaqepsi dhe i aftëson ata të kryejnë qepjen e pensave, palave e filetove, formimin e molesave, si dhe përgatitjen e frudave dhe rrudhave.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti qep pensa. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë llojet e pensave dhe përdorimet e tyre në veshje të ndryshme;- të shpjegojë procedurën e qepjes së pensave;- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për qepjen e pensave;- të përgatitë vendin e punës për qepjen e pensave;- të llogarisë vendin dhe masën e pensës;- të përzgjedhë mjetet matëse dhe shënuese;- të kryejë matjet dhe shënimet për pensat;- të dallojë shenjat e shënuara të pensave;- të kryejë matjet dhe të shënojë me pasi, me pasqyrim ose me gjilpëra me kokë vendet ku duhet qepur pensa.- të kryejë qepjen sipas shënimeve të bëra;- të kryejë hekurosjen e pensave;- të tregojë kujdes në simetrinë e pensave.- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për qepjen e pensave;- të komunikojë me etikë profesionale.- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM 2 Kursanti formon molesa. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë llojet e molesave (mbulesave) dhe përdorimet e tyre në veshje të ndryshme;- të shpjegojë procedurën e formimit të molesave;- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për formimin e	

- molesave;
- të përgatitë vendin e punës për formimin e molesave;
- të llogarisë vendin dhe masën e molesës;
- të përzgjedhë mjetet matëse dhe shënuese;
- të kryejë matjet dhe shënimet për molesat;
- të dallojë shenjat e shënuara të molesave;
- të kryejë ildisjen dhe qepjen e molesave sipas shënimeve të bëra;
- të tregojë kujdes në simetrinë e molesave.
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për formimin e molesave;
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti përgatit rrudha

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet e rrudhave (frudave) dhe përdorimet e tyre në veshje të ndryshme;
- të shpjegojë procedurën e përgatitjes së rrudhave;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përgatitjen e rrudhave;
- të përgatitë vendin e punës për përgatitjen e rrudhave;
- të llogarisë vendin dhe masën e rrudhave
- të dallojë shenjat e shënuara të rrudhave
- të ildisë dhe përgatisë në makinë me tegela sipërfaqen e rrudhave
- të tregojë kujdes në simetrinë e rrudhave
- të bëjë qepjen e rrudhave
- të bëjë hekurosjen e rrudhave
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për përgatitjen e rrudhave;
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti qep pala

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet e palave dhe përdorimet e tyre në veshje të ndryshme;
- të shpjegojë procedurën e qepjes së palave;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për qepjen e palave;

- të përgatitë vendin e punës për qepjen e palave;
- të llogarisë vendin dhe masën e palave
- të dallojë shenjat e shënuara të palave
- të shënojë vendet ku duhen qepur palat
- të bëjë qepjen sipas shenjave
- të bëjë hekurosjen e palave
- të tregojë kujdes në simetrinë e palave
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për qepjen e palave;
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë;
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti qep fileto

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet e filetove dhe përdorimet e tyre në veshje të ndryshme;
- të shpjegojë procedurën e qepjes së filetove;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për qepjen e filetove;
- të përgatitë vendin e punës për qepjen e filetove;
- të llogarisë gjërësinë dhe gjatësinë e filetos
- të presë saktësisht fileton
- të pregatisë me ildi fileton për qepje në makinë
- të bëjë qepjen e filetos
- të bëjë hekurosjen e filetove
- të sistemojë dhe mirëmbajnë vendin dhe mjetet për qepjen e filetove;
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për të kryer proceset e qepjes dhe formimit të pensave, molesave, rrudhave, palave dhe filetove, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që

të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Veshje të ndryshme
 - Copa dhe materiale ndihmëse për realizimin e pensave, molesave, rrudhave, palave dhe filetove.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Qepja me makina qepëse familjare dhe industriale”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	QEPJA ME MAKINA QEPESE FAMILJARE DHE INDUSTRIALE	MK-10-115-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me llojet e ndryshme të makinave qepëse familjare dhe industriale, si dhe i aftëson ata për të kryer qepje me makina familjare, makinat syzator, makinat lineare, makinat e birkopsave, si dhe për të rregulluar defektet e thjeshta në procesin e qepjes me makina.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përshkruan llojet, ndërtimin, funksionimin dhe përdorimet e makinave qepëse. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të argumentojë rëndësinë e përdorimit të makinave qepëse në rrobaqepsi; - të përshkruajë funksionet e makinave qepëse; - të tregojë ndërtimin e përgjithshëm të makinave qepëse dhe funksionet e pjesëve kryesore të makinës; - të dallojë llojet e ndryshme të makinave qepëse (familjare, industriale, me këmbë, me enregji elektrike, me komandim elektronik etj.) dhe të tregojë përdorimet e tyre; - të bëjë dallimin e makinave qepëse sipas proceseve të ndryshme (lineare, dygjilpërësh, syzatorë etj.). - të tregojë mënyrën e vendosjes së fillit në makinë - të tregojë mënyrën e mbushjes së suvajkes. - të përshkruajë masat për kujdesin dhe mirëmbajtjen e makinave qepëse. - të përshkruajë rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të makinave qepëse. - të komunikojë me etikë profesionale. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. 	
	<p>RM 2 Kursanti kryen qepje me makinat qepëse familjare Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinën qepëse familjare. - të përzgjedhë materialet e punës; 	

- të përgatisë për punë makinën qepëse familjare.
- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse familjare.
- të vendosë dhe të fiksojë fijen, gjilpërën e duhur dhe suvajkën në makinë.
- të regjistrojë hapin e tegelit sipas procesit dhe llojit të tekstilit.
- të regjistrojë shpejtësinë e makinës sipas proçeseve;
- të vendosë dhe udhëzojë lëvizjen e copës që do të qepet;
- të kryej qepjen e tegelave të drejtë pa ndalesë me çpimet mbi linjë;
- të kryej qepjen e tegelave të drejtë dhe kënde me gjilpërë në kënde të vendosur thellë;
- të kryejë qepjen e tegelave duke drejtuar dorën që bën rrethin
- të kryejë qepjen e tegelave deri tek cepi i tegelave me kthesë, dora rrotullohet në rreth;
- të kryejë qepjen e tegelave të zbukurimit 5 mm të gjerë dhe gjatësi të ndryshme;
- të vendosë këmbëzat e ndryshme (per zinxhirin, palën, lineare etj.).
- të qepë gjëra të thjeshta (bashkime copash, kthim pale, etj.).
- të rregullojë difekte të thjeshta që shfaqen gjatë punës;
- të pastrojë vendin e punës.
- të mirëmbajë makinën qepëse familjare (pastrim dhe vajosje)
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen qepje në makinat qepëse syzator

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinën qepëse syzator.
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të përgatisë për punë makinën qepëse syzator.
- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse syzator.
- të vendosë dhe të fiksojë fijet dhe gjilpërën e duhur
- të regjistrojë hapin e tegelit sipas procesit dhe llojit të tekstilit.
- të regjistrojë shpejtësinë e makinës sipas proçeseve;
- të kryejë qepje të ndryshme me makinën syzator
- të rregullojë defekte të thjeshta në makinën syzator.
- të pastrojë vendin e punës.
- të mirëmbajë makinën qepëse syzator (pastrim dhe vajosje)
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së

- mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen qepje në makinat qepëse lineare

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepje në makinën qepëse lineare (industriale).
- të përzgjedhë drejt materialet e punës
- të përgatisë për punë makinën qepëse lineare.
- të vendosë gjilpërën në makinë në mënyrën e duhur
- të vendosë perin e sipërm
- të kontrollojë lirimimin dhe shtrëngimin e perit.
- të mbërthejë (zbërthejë) folenë e masurit në makinën qepëse lineare.
- të qepë tegela në makinën qepëse lineare.
- të rregulloje defekte te thjeshta në makinën lineare.
- të pastrojë vendin e punës.
- të mirëmbajë makinën qepëse lineare (pastrim dhe vajosje)
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen qepje në makinat qepëse të birkopsave

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepje në makinën qepëse të birkopsave.
- të përzgjedhë drejt materialet e punës
- të përgatisë për punë makinën qepëse të birkopsave.
- të rregullojë parametrat makinës për bërjen e vrimave sipas tekstileve.
- të qepë vrimat në makinën e birkopsave duke zbatuar procedurat e punës.
- të rregullojë parametrat makinës për qepjen e kopsave.
- të qepë kopsa duke zbatuar procedurat e punës.
- të rregullojë defekte te thjeshta në makinat e qepjes së birkopsave.
- të rregulloje defekte te thjeshta në makinën e birkopsave.
- të pastrojë vendin e punës.
- të mirëmbajë makinën qepëse të birkopsave (pastrim dhe vajosje)
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;

- të komunikojë me etikë profesionale

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Kursanti rregullon defektet e thjeshta në procesin e qepjes me makina

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vëndin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve në makinat qepëse.
- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës
- të rregullojë tegelin nga lirimi i penjve në makinat qepëse
- të rregulloje tegelin nga shtrëngimi i perit në makinat qepëse
- të rregullojë tegelin nga faktorë të ndryshëm.
- të rregullojë lënien e pontit në makinat qepëse
- të rregullojë defektin e këputjes së perit në makinat.
- të mirëmbajë dhe të kryejë shërbimet e duhura në makinat qepëse (vajosjen).
- të pastrojë vëndin e punës dhe makinat qepëse
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
- të komunikojë me etikë profesionale

Instrumente e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për të kryer procese të qepjeve të ndryshme, me makina të ndryshme familjare dhe industriale, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
- Makina qepëse të ndryshme, familjare dhe industriale
- Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
- Copa të ndryshme.
- Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Konfeksionimi i fundeve”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I FUNDEVE	MK-10-116-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeht kursantët me procedurat e përgatitjes së fundit të thjeshtë si dhe i aftëson ata për përgatitjen e kallëpit të fundit të thjeshtë, prerjen dhe qepjen e tij, si dhe për qepjen e fundeve me modele të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit kallëpin e fundit të thjeshtë. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e ndërtimit të kallëpëve të prerjes së fundit të thjeshtë.- të përzgjedhë metodën e duhur për ndërtimin e kallëpëve të prerjes së fundit të thjeshtë.- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e kallëpëve të prerjes së fundit të thjeshtë.- të përdorë tabelat e masave trupore.- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit.- të realizojë skicën e fundit të thjeshtë sipas kërkesave të klientit.- të marrë masat e nevojshme tek klienti.- të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes të fundit thjeshtë.- të ndërtojë kallëpët e prerjes së fundit të thjeshtë sipas përmasave reale.- të kontrollojë saktësinë e kallëpëve të prerjes.- të vendosë shenjat përkatëse të referimit.- të presë kallëpët e fundit të thjeshtë.- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.- të komunikojë me etikë profesionale- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti pret fundin e thjeshtë <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e	

- e prerjes së pjesëve të fundit të thjeshtë.
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e prerjes së pjesëve të fundit të thjeshtë.
- të përcaktojë gjatësinë e materialit.
- të përgatisë pëlhurën për prerje duke zgjedhur drejtimin e duhur.
- të vendosë sipas drejtimit të duhur kallëpët mbi pëlhurë.
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët përbërëse të kallëpëve.
- të shënojë mbi pëlhurë rezervat e qepjes.
- të presë pjesët e fundit sipas kallëpëve të prerjes duke ekonomizuar lëndën e parë.
- të shënojë dhe kompletojë si duhet pjesët e prera.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti qep fundin e thjeshtë

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e qepjes së fundit të thjeshtë.
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e qepjes së fundit të thjeshtë.
- të përgatisë makinat e nevojshme për punë.
- të kopjojë me penjë kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme, tek shpina dhe përparësja e fundit.
- të ildisë pensat e fundit.
- të hekurosë pensat e fundit.
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e fundit.
- të kryej provën e qëndrimit në trup të fundit.
- të kryej rregullimin e fundit pas kryerjes së provës.
- të qepë sipas rradhës fundin e thjeshtë.
- të fiksojë drejt materialin ngjitës me pëlhurën.
- të qepë astarin.
- të qepë fundin e thjeshtë.
- të qepë zinxhirin në fundin të thjeshtë.
- të bashkojë astarin me fundin.
- të kryejë punime të nevojshme përfundimtare.
- të kontrollojë saktësinë e proceseve të qepjes së fundit të thjeshtë.
- të vendosë aksesorë të ndryshëm.
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fundit të thjeshtë.
- të paketojë dhe ambalazhojë fundin e thjeshtë.
- të llogarisë koston e produktit të realizuar.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale

- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti qep funde me supanjë dhe pala

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e qepjes së fundit me supanjë dhe pala.
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e qepjes së fundit me supanjë dhe pala.
- të përgatisë makinat e nevojshme për punë.
- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit.
- të realizojë skica të modeleve të ndryshme të fundeve me supanjë dhe pala.
- të marrë masat e nevojshme tek klienti.
- të përpunojë kallëpin e veshjes së kërkuar sipas masave dhe modelit.
- të llogarisë madhësinë e palave sipas modelit.
- të ndërtojë kallëpët e prerjes së fundit të modeluar sipas përmasave reale.
- të kontrollojë saktësinë e kallëpëve të prerjes.
- të presë kallëpët e fundit me supanjë dhe pala.
- të përcaktojë gjatësinë e materialit për prerje.
- të përgatisë pëlhurën për prerje duke zgjedhur drejtimin e duhur.
- të vendosë sipas drejtimit të duhur kallëpët mbi pëlhurë.
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët përbërëse të kallëpëve.
- të vendosë shenjat përkatëse të referimit.
- të shënojë mbi pëlhurë rezervat e qepjes.
- të presë pjesët e fundit sipas kallëpëve të prerjes duke ekonomizuar lëndën e parë.
- të shënojë dhe kompletojë si duhet pjesët e prera.
- të kopjojë me penjë kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme, tek shpina dhe përparësja e fundit.
- të ildisë palat e fundit sipas cikatjeve.
- të hekurosë palat e fundit.
- të bashkojë me ildi pjesët e fundit me pala me pjesën e supanjës.
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e fundit.
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundit.
- të kryejë rregullimin e fundit pas kryerjes së provës .
- të qepë sipas rradhës fundin me supanjë dhe pala.
- të fiksojë drejt materialin ngjites me pëlhurë.
- të qepë astarin e fundin.
- të bashkojë astarin me fundin.
- të kontrollojë saktësinë e proceseve të qepjes së fundit.
- të kryejë punimet e nevojshme përfundimtare.

- të vendosë aksesorë të ndryshëm.
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fundit.
- të paketojë dhe ambalazhojë fundin e thjeshtë.
- të llogarisë koston e produktit të realizuar.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti qep funde me modele xheshash të ndryshëm

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e qepjes së fundit me modele xheshash të ndryshëm.
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e qepjes së fundit me modele xheshash të ndryshëm.
- të përgatisë makinat e nevojshme për punë.
- të realizojë skica të modeleve të ndryshme të fundeve me modele xheshash të ndryshëm.
- të realizojë skica të thjeshta të modeleve të fundeve me xhepa të ndryshëm si xhepa pllakë, xhepa me fileto dhe kapak, xhepa anësorë etj.
- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit të fundit
- të marrë masat e nevojshme tek klienti.
- të ndërtojë kallëpët e prerjes së fundit me modelin e përzgjedhur me masa reale.
- të përcaktojë formën e xhepit sipas modelit të kërkuar.
- të përpunojë kallëpin e veshjes së kërkuar sipas masave dhe modelit.
- të kontrollojë saktësinë e kallëpëve të prerjes.
- të vendosë shenjat përkatëse të referimit.
- të presë kallëpët e fundit me modele xheshash të ndryshëm.
- të përcaktojë gjatësinë e materialit për prerje.
- të përgatisë pëlhurën për prerje duke zgjedhur drejtimin e duhur.
- të vendosë sipas drejtimit të duhur kallëpët mbi pëlhurë.
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët përbërëse të kallëpëve.
- të vendosë shenjat përkatëse të referimit.
- të shënojë mbi pëlhurë rezervat e qepjes.
- të presë pjesët e fundit sipas kallëpëve të prerjes duke ekonomizuar lëndën e parë.
- të shënojë dhe kompletojë si duhet pjesët e prera.
- të kopjojë me penjë kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme, tek shpina dhe përparësja e fundit.
- të përcaktojë vendodhjen e xhepave të fundit sipas

cikatjeve.

- të presë xhepat e fundit sipas modelit.
- të qepë astarin në pjesën e xhepit.
- të hekurosë xhepat e fundit.
- të bashkojë xhepat me pjesët e fundit.
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e fundit.
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundit.
- të kryejë rregullimin e defekteve të fundit pas kryerjes së provës.
- të qepë sipas rradhës fundin e modeluar.
- të fiksojë drejt materialin ngjites me pëlhurë.
- të qepë astarin e fundin.
- të bashkojë astarin me fundin.
- të kontrollojë saktësinë e proceseve të qepjes së fundit.
- të kryejë punimet e nevojshme përfundimtare.
- të vendosë aksesorë të ndryshëm.
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fundit.
- të paketojë dhe ambalazhojë fundin e thjeshtë.
- të llogarisë koston e produktit të realizuar.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për përgatitjen e kallëpit të fundit të thjeshtë, prerjen dhe qepjen e tij, si dhe për qepjen e fundeve me modele të ndryshme, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Makina qepëse.
 - Copa dhe materiale ndihmëse të ndryshme për përgatitjen e fundeve të ndryshme.
 - Sica dhe katalogë të fundeve të ndryshme.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Konfeksionimi i jakave, mëngëve dhe xhepave”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I JAKAVE, MËNGËVE DHE XHEPAVE	MK-10-117-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njej kursantët me procedurat e konfeksionimit të jakave, mëngëve dhe xhepave, si dhe i aftëson ata që ti realizojnë këto produkte.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti konfeksionon jaka. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e konfeksionimit të jakave.- të përzgjedhë metodën e duhur për ndërtimin e kallëpit të prerjes sipas modelit të jakës.- të realizojë skica të thjeshta për modele jakash të ndryshme.- të përzgjedhë materialet e duhura për konfeksionimin e jakave.- të ndërtojë e kallëpe të prerjes sipas modeleve të ndryshme të jakave.- të presë në tekstil modele të jakave- të shënojë qëndrën e jakës tek dy pjesët e saj.- të frazelinojë pjesën e jashtme të jakës.- të bashkojë dy pjesët e jakës nga ana e mbarë.- të vendosë jakën në anën e mbarë të veshjes mbi harkun e qafës.- të bashkojë shenjat e jakës me veshjen.- të ildisë jakën në harkun e qafës.- të qepë supet e mostrave.- të hapë me hekur bashkimin e supeve të mostrave.- të vendosë anën e mbarë të mostrës mbi jakën.- të përputhë shenjat orientuese të mostrës me ato të jakës.- të ildisë shtresën e krijuar (veshja, jaka dhe mostra) nga ana e veshjes.- të qepë me makinë shtresën e krijuar (veshja, jaka dhe mostra) nga ana e veshjes.- të kthejë me ildi mostrën.- të kryejë matje dhe shënime të sakta.- të llogarisë koston e produktit të realizuar.- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.	

-
- të komunikojë me etikë profesionale
 - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti konfeksionon mëngë

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e konfeksionimit të mëngës me dorezë.
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e prerjes së pjesëve të mëngës dhe dorezës.
- të përzgjedhë materialet e duhura për realizimin e mëngës.
- të ndërtojë e kallëpe të prerjes sipas modeleve të ndryshme të mëngëve.
- të presë mëngën në pëlhurë.
- të qepë pjesën anësore e mëngës.
- të përforcojë tegelin ku do të fillojë hapja e mëngës.
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e dorezave dhe qepjen e tyre në mëngë.
- të përzgjedhë materialet e punës.
- të presë dorezat sa gjerësia e mëngës.
- të frazelinojë dorezat.
- të qepë me makinë dy anësoret e dorezës, pasi të ketë bashkuar saktë anët e mbara të tyre.
- të kthejë dorezën e qepur.
- të ildisë njërën anë të dorezës me mëngën.
- të qepë me makinë njërën anë të dorezës me mëngën
- të kthejë pjesën tjetër të dorezës.
- të ildisë pjesën tjetër të dorezës, duke e mbuluar tegelin e qepjes.
- të qepë me tegel dekorativ nga ana e mbarë dorezën me mëngën
- të heqë ilditë
- të hekurosë dorezën e përfunduar.
- të qepë vrimën e kopsës në makinë ose me dorë.
- të qepë kopsën, pasi të ketë shënuar pozicionin e saktë.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta.
- të llogarisë koston e produktit të realizuar.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti konfeksionon xhepa

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatisë vendin dhe mjetet e punës për konfeksionimin e xhepit (pa astar dhe me astar).
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e duhura për konfeksionimin e xhepit (pa astar dhe me astar).
- të përzgjedhë materialet e duhura për konfeksionimin e xhepit.
- të skicojë xhepin sipas formës së përzgjedhur.
- të presë xhepin pa astar sipas skicës.
- të palosë bordurën e xhepit në anën e mbarë.
- të qepë pjesën fundore të bordurës me tegel.
- të qepë së bashku pjesët anësore të drejta të bordurës me xhepin.
- të kthejë bordurën.
- të përthyej pjesët anësore të xhepit në anën e pasme.
- të qepë këndet e drejta në pjesët anësore të poshtme kur xhepi është kënddrejtë.
- të hekurosë xhepin.
- të vendosë xhepin në veshje dhe ta ildisë.
- të qepë xhepin me makinë.
- të presë xhepin me astar.
- të qepë pjesën e lartme të xhepit me astarin.
- të krijojë hapësirën për për kthimin e xhepit.
- të palosë bordurën e xhepit.
- të qepë xhepin me astarin.
- të presë këndet e xhepit kënddrejtë.
- të cikatë pjesët anësore të xhepit me anë të harkuara.
- të kthejë xhepin në anën e mbarë.
- të qepë pjesën e hapur të xhepit.
- të rrotullojë xhepin në anën e prapme të tij.
- të ildisë xhepin e kthyer.
- të vendosë xhepin në veshje dhe ta ildisë.
- të qepë xhepin me makinë.
- të hekurosë xhepin.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit. të sistemojë vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me

objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.

- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për konfeksionimin e jakave, mëngëve dhe xhepave të ndryshëm, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Skica dhe katalogë të jakave, mëngëve dhe xhepave.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për përgatitjen dhe qepjen e jakave, xhepave dhe mëngëve.
-

7. Moduli “Konfeksionimi i pantallonave”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I PANTALLONAVE	MK-10-118-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e konfeksionimit të pantallonave, si dhe i aftëson ata që të realizojnë konfeksionimin e pantallonave të llojeve të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti përgatit kallëpin e pantallonave <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin e punës - të përzgjedhë veglat, materialet, makinat dhe pajisjet e nevojshme për punë. - të përzgjedhë copën dhe materialet ndihmëse për konfeksionimin e pantallonit. - të përdorë tabelat e masave trupore. - të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit të pantallonit. - të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes së pantallonit. - të marrë masat e nevojshme tek klienti. - të realizojë skicën e pantallonit sipas kërkesave të klientit. - të ndërtojë kallëpin e pantallonit. - të shënojë saktë pencat dhe palat. - të shënojë saktë qemerin, sallkin, xhepat. - të komunikojë me etikë profesionale. - të respektojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë prerjes së kallëpit të pantallonave. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Kursanti pret pantallonat. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë vendin e punës - të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë. - të përzgjedhë tekstin e duhur dhe materialet ndihmëse 	

për pantallonin

- të vendosë saktë kallëpin në tekstin për pantallonin.
- të shënojë me shkumës tekstin sipas modelit.
- të shënojë pencat dhe palat.
- të shënojë hapësirat e qepjes për pantallonin.
- të presë pjesët e pantallonit sipas kallëpëve të prerjes duke ekonomizuar lëndën e parë.
- të presë saktë filetot e xhepave
- të presë saktë me gërshtë astarin e xhepave.
- të presë qemerin sipas masave të duhura.
- të presë frazelinën për qemerin, filetot dhe mostrat.
- të kryejë ngjitjen e frazelinës me hekur.
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të respektojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë prerjes së pantallonave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me liste kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 3 Kursanti kryen provën e pantallonave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të kryejë ildisjen e bazës së pantallonit për provë
- të kryej provën e pantallonit.
- të shënojë rregullimet e duhura pas provës
- të kryejë rregullimet e duhura pas provës së pantallonit.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë gjatë provës së pantallonave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 4 Kursanti qep pantallonat.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës
- të përzgjedhë veglat, materialet, makinat dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të përgatisë makinën qepëse për punë.
- të vendosë zinxhirin e pantallonit.
- të vendosë sallkinë.
- të kryejë qepjen e xhepave përpara.

- të kryejë qepjen e xhepave filet mbrapa.
- të kryejë pastrimin me syzator.
- të kryejë qepjen e pencave dhe palave.
- të kryejë qepjen e pjesëve mbrapa.
- të kryejë rafitë anësore.
- të vendos ylykët.
- të kryejë qepjen e qemerit
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të respektojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë prerjes dhe qepjes së pantallonave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.

RM 5 Kursanti kryen proceset përfundimtare të pantallonave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës
- të përzgjedhë veglat, materialet, makinat dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të përgatisë makinën qepëse për punë.
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë te pantallonit.
- të kryejë qepjen palës së pantallonit
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të pantallonit.
- të kryejë paketimin e pantallonit.
- të llogarisë koston e përgatitjes së pantallonit.
- të pastrojë vendin e punës
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të respektojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë proceseve përfundimtare të përgatitjes së pantallonave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe të simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra

praktike për përgatitjen e kallëpit, prerjen, qepjen, provën dhe finalizimin e pantallonave, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Komplet i materialeve, aksesorëve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Skica dhe katalogë të pantallonave të ndryshme për meshkuj dhe femra.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për konfeksionimin e pantallonave.
-

8. Moduli “Konfeksionimi i këmishave”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I KEMISHAVE	MK-10-119-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e konfeksionimit të këmishave, si dhe i aftëson ata që të realizojnë konfeksionimin e këmishave të llojeve të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit kallëpin e këmishës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.- të përzgjedhë copën dhe materialet ndihmëse për konfeksionimin e këmishës.- të përdorë tabelat e masave trupore.- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit të këmishës.- të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes së këmishës.- të marrë masat e klientit për këmishën.- të skicojë modelin e këmishës.- të ndërtojë kallëpin e këmishës.- të përcaktojë pensat në pjesën e përparme dhe të mbrapme të këmishës- të përgatisë bordurën për kopsa- të ndërtojë kallëpin e mëngës së këmishës- të përshtase mëngën me bazen e trupit- të ndërtojë kallëpin jakës së këmishës.- të shënojë xhepin,- të përshtasë jakën me bazen e trupit- të përgatisë kallëpin e manshetave- të shënojë xhepin, jakën, manshetat- të komunikojë me etikë profesionale- të zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë përgatitjes së kallëpit të këmishës. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.	

-
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti pret këmishën.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës
- të përzgjedhë veglat, materiale dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të kontrollojë masat e klientit për këmishë.
- të vendosë kallëpin e bazës së këmishës në copë.
- të shënojë me shkumës modelin e këmishës.
- të shënojë hapësirat e qepjes sipas modelit
- të shënojë pensat në pjesën e përparme dhe të mbrapme të këmishës
- të vendosë kallëpin mëngës.
- të shënojë me shkumës kallëpin e mëngës
- të shënojë hapsirat e qepjes për mëngën
- të vendosë kallëpin e jakës në copë.
- të shënojë me shkumës kallëpin e jakës.
- të shënojë hapësirat e qepjes për jakën.
- të vendosë kallëpin xhepit në copë.
- të shënojë me shkumës kallëpin e xhepit
- të shënojë hapsirat e qepjes për xhepin.
- të presë me gërshërë copën sipas shënimeve duke ekonomizuar copën.
- të presë frazelinën për jakën.
- të presë frazelinën për bordurën e kopsave.
- të presë frazelinën për manshetat.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë prerjes së këmishës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 3 Kursanti kryen provën e këmishës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës.
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të kryejë ildisjen e bazës së trupit.
- të kryejë ildisjen pensave.
- të kryejë ildisjen mëngëvë.
- të kryejë bashkimin e trupit me mëngën.

- të kryejë provën e këmishës.
- të shënojë difektet pas provës së këmishës.
- të kryejë rregullimet e duhura pas provës së këmishës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë provës së këmishës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 4 Kursanti qep këmishën.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës.
- të përzgjedhë veglat, materialet, makinat dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të kryejë qepjen e bazës së trupit të këmishës
- të kryejë qepjen pensave.
- të kryejë qepjen mëngëve
- të kryejë qepjen e trupit me mëngët.
- të kryejë ngjitjen e jakës me frazelinë.
- të kryejë ngjitjen e manshetave me frazelinë
- të kryejë ngjitjen e bordurës së kopsave me frazelinë.
- të kryejë bashkimin e pjesëve të jakës më vete.
- të kryejë tegelat e zbukurimit të jakës, manshetave, bordures, etj.
- të kryejë qepjen e bordurës së kopsave.
- të kryejë bashkimin e jakës me trupin.
- të kryejë proven e dytë të këmishës.
- të shënojë difektet pas provës së dytë të këmishës.
- të kryejë rregullimet e duhura pas provës së këmishës.
- të komunikojë me etikë profesionale.
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë qepjes së këmishës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 5 Kursanti kryen proceset përfundimtare të këmishës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës.
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme.
- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të këmishës.

- të kryejë qepjen e palës së këmishës.
- të shënojë vendin e vrimave të kopsave.
- të kryejë vrimat e kopsave me makinë ose me dorë.
- të shënojë vendin e kopsave.
- të kryejë qepjen e kopsave të këmishës.
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të këmishës.
- të kryejë paketimin e këmishës.
- të sistemojë vendin dhe mjetet e punës.
- të llogarisë koston e këmishës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë konfeksionimit të këmishës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe të simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për përgatitjen e kallëpit, prerjen, qepjen, provën dhe finalizimin e këmishave, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në rrobaqepsi.
 - Komplet i materialeve, aksesorëve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Skica dhe katalogë të këmishave të ndryshme.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për konfeksionimin e këmishave.
-

9. Moduli “Konfeksionimi i fustaneve”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I FUSTANEVE	MK-10-120-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e konfeksionimit të fustaneve, si dhe i aftëson ata që të realizojnë konfeksionimin e fustaneve të llojeve të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e rrobaqepsisë” dhe “Punime të thjeshta në rrobaqepsi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit kallëpin e fustanit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.- të përzgjedhë copën dhe materialet ndihmëse për konfeksionimin e fustanit.- të përdorë tabelat e masave trupore.- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit të fustanit.- të shpjegojë mënyrën e realizimit të ndërtimit të kallëpit të prerjes së fustanit.- të marrë masat e klientit për fustanin.- të skicojë modelin e fustanit.- të ndërtojë kallëpin e fustanit.- të përcaktojë pensat në pjesën e përparme dhe të mbrapme të fustanit.- të përcaktojë modelin e jakës (jakë kemishe, jakë bebe, jakë filet etj.).- të ndërtojë kallëpin e mëngës- të përshtasë mëngën me bazën e trupit- të ndërtojë kallëpin jakës.- të shënojë xhepat (nese ka).- të përshtasë jakën me bazën e trupit- të shënojë xhepin, jakën në kallup.- të shënojë mostrat e fustanit në kallup.- të komunikojë me etikë profesionale.- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë përgatitjes së kallëpit të fustanit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti pret fustanin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të përzgjedhë copën dhe materialet ndihmëse për fustanin.
- të kontrollojë masat e klientit për fustan.
- të vendosë kallëpin e bazës së fustanit në copë.
- të shënojë me shkumës modelin e fustanit.
- të shënojë hapësirat e qepjes sipas modelit të fustanit.
- të shënojë pensat në pjesën e përparme dhe të mbrapme të fustanit në copë
- të vendosë kallëpin e mëngës në copë.
- të shënojë me shkumës kallëpin e mëngës së fustanit.
- të shënojë hapësirat e qepjes për mëngën e fustanit.
- të vendosë kallëpin e jakës sipas modelit në copë.
- të shënojë me shkumës kallëpin e jakës.
- të shënojë hapësirat e qepjes për jakën.
- të vendosë kallëpin xhepave në copë.
- të shënojë me shkumës kallëpin e xhepit në copë.
- të shënojë hapësirat e qepjes për xhepin në copë.
- të presë me gërshëre copën sipas shënimeve duke ekonomizuar copën.
- të presë mostrat e fustanit në copë.
- të presë me frazelinë pjesët e dhura të fustanit.
- të sistemojë vendin dhe mjetet e punës.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 3 Kursanti kryen provën e fustanit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës.
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të kryejë ildisjen e bazës së trupit të fustanit.

- të kryejë ildisjen pensave të fustanit.
- të kryejë ildisjen mëngëve të fustanit.
- të bashkojë trupin me mëngët e fustanit.
- të kryejë provën e fustanit.
- të shenojë difektet pas provës së fustanit.
- të kryejë rregullimet e duhura pas provës së fustanit.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë provës së fustanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 4 Kursanti qep fustanin.

Kriteret e vlerësimit:

- të përgatisë vendin e punës
- të përzgjedhë veglat, materialet, makinat dhe pajisjet e nevojshme për punë.
- të kryejë qepjen e bazës së trupit.
- të kryejë qepjen pensave të fustanit.
- të kryejë qepjen e mëngëve të fustanit.
- të kryejë qepjen e trupit me mëngët e fustanit.
- të kryejë ngjitjen me hekur të frazelinës së jakës.
- të kryejë qepje më vete të jakës së fustanit.
- të kryejë tegelat e zbukurimit të jakës (nëse ka).
- të kryejë qepjen e zinxhirit të fshehtë ose normal të fustanit
- të kryejë qepjen e mostrave të fustanit.
- të kryejë qepjen e xhepave mbi fustan.
- të kryejë proven e dytë të fustanit.
- të shënojë difektet pas provës së fustanit.
- të kryejë rregullimet (rregullarin) e duhura pas provës së fustanit.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

RM 5 Kursanti kryen proceset përfundimtare të fustanit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin e punës.
- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë.

- të kryejë proceset përfundimtare të qepjes me dorë të fustanit.
- të kryejë qepjen palës së fustanit me dorë ose me ngjitje.
- të kryejë qepjen e palës së mëngëve me dorë, me ngjitje.
- të kryejë qepjen e kopsave, sustave, etj.
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të fustanit.
- të kryejë paketimin e fustanit.
- të sistemojë mjetet dhe vendin e punës.
- të llogarisë koston e konfeksionimit të fustanit.
- të komunikojë me etikë profesionale
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë prerjes së fustanit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së rrobaqepsisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepsisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe të simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepsi. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për përgatitjen e kallëpit, prerjen, qepjen, provën dhe finalizimin e fustaneve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në rrobaqepsi.
 - Komplet i materialeve, aksesorëve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në rrobaqepsi.
 - Skica dhe katalogë të fustaneve të ndryshme.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për konfeksionimin e fustanëve.
-